# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 148

**Tiranë – E Martë, 30 Shtator 2014**

## PËRMBAJTJA

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 561, datë 30.8.2014 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin "Nënë Tereza"", miratuar me vendimin nr.27/2014, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR)........ | 6753 |
| Vendim i KM nr. 611, datë 17.9.2014 | Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Rajonale për Evropën Juglindore, 2014 – 2020........ | 6754 |
| Vendim i KM nr. 612, datë 17.9.2014 | Për riorganizimin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian........ | 6777 |
| Vendim i KM nr. 613, datë 17.9.2014 | Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pronës nr. 1051, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 5013, n/repart", me vendndodhje në Bigaz, Skrapar", dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar........ | 6777 |
| Vendim i KM nr. 614, datë 17.9.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1507, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës hyrëse – Shkodër"........ | 6778 |
| Vendim i KM nr. 616, datë 17.9.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 228, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë – Elbasan"........ | 6779 |

**VENDIM**
**Nr. 561, datë 30.8.2014**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "NDËRHYRJE TË PËRKOHSHME DHE REHABILITUESE NË SHESHIN "NËNË TEREZA"", MIRATUAR ME VENDIMIN NR.27/2014, TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RESTAURIMEVE (KKR)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin "Nënë Tereza"", miratuar me vendimin nr.27/2014, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall, me një vlerë të përgjithshme 5 411 435 (pesë milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë, dhe për pasuritë ndërtim, me një vlerë të përgjithshme 30 695 749 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 36 107 184 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

5. Shpronësimi të fillojë në datën 30.8.2014.

6. Shpenzimet për botimet publike në gazeta, në masën 306 250 (treqind e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, të përballohen nga zëri "602" i aparatit të Ministrisë së Kulturës.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Plotësim dokumentacioni", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

9. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Bllokuar nga bankat", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

LISTA E PASURIVE TE PALUAJTESHME PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER MARRJEN NE PERDORIM TE PERKOHSHEM PER INTERES PUBLIK, TE CILAT PREKEN NGA

| Nr | Pronari | Zona kadastrale | Nr. pasurie | Siperfaqe | | Çmimi Leke/m2 | | Vlera Leke | | | SHENIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Truall | Ndertim | Truall | Ndertim | Truallit | Ndertese | Banese | |
| 1 | FLUTURA HASAN CELA,<br>LILJANA PETROR SOTIRI,<br>NAZE HASAN SUBASHI,<br>QEMAL GEGA,<br>VJOLLCA NAGJELI<br>SHTETI | 8280 | 2/8-ND | | 104 | | 12445.71 | | 1,294,354 | | Plotesim dokumentacioni |
| 2 | HODO VELAJ<br>SHTET | 8160 | 7/11-N2 | | 94.5 | | 25769.97 | | 2,435,262 | | Plotesim dokumentacioni |
| 3 | ROVAN LIMON LUKU | 8280 | 2/327 | 72m2 | 299.8 | 23955 | 43894.79 | 1,724,760 | 13,159,659 | | Bllokuar ne favor te UNION BANK |
| 4 | PERSEFONI KRISTO KOKA | 8280 | 2/13 | 51m2 | 60.9 | 23955 | 23944.33 | 1,221,705 | 1,458,210 | | Konfirmuar nga ZRVPP |
| 5 | MAJLINDA XHEVAHIR ZALLA<br>VIPAUTO sh.p.k.<br>VIPAUTO SH.P.K.<br>LIONMAX KONSTRUKSION | 8280 | 2/337<br>2/336<br>2/11<br>2/267 | 22.9m2<br>22.9m2<br>31.6m2<br>25.5m2 | 104.5 | 23955 | 65961.67 | 2,464,970 | 6,892,995 | | 2/11 bllokuar ne favor te UNION BANK<br>2/336 Bllokuar ne favor te UNION BANK |
| 6 | MAK-ALBANIA sh.p.k.<br>SHTET | 8160 | 7/11-N3 | | 140 | | 34241.91 | | 4,793,867 | | Plotesim dokumentacioni |
| 7 | LILJANA PETRO SOTIRI<br>VJOLLCA RUSHIT ANGJELI<br>FLUTURA HASAN CELA<br>QEMAL LIAL GEGA<br>SHTET | 8280 | 2/334-ND/2 | 40m2 | 48.9 | | 13525.6 | | 661,402 | | Plotesim dokumentacioni |
| 8 | | | | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | | | | |
| | | | | - | 852.6 | | | 5,411,435 | 30,695,749 | - | 36,107,184 |
| | TOTALI | | | | Leke | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 611, datë 17.9.2014**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË RAJONALE PËR EVROPËN JUGLINDORE, 2014 - 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për zbatimin e Strategjisë Rajonale për Evropën Juglindore, 2014 - 2020, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË RAJONALE SEE 2014-2020

| Objektivat e strategjisë | | | Aktivitete dhe masa që do të zhvillohen | Institucioni përgjegjës dhe partneret | Afati për realizimin e tyre | Kostot në milion Lekë | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SHTYLLA 1: RRITJE E INTEGRUAR | | | | | | | |
| Dimensioni : A Zona e tregtisë së lirë | | | | | | | |
| A.1 | Reduktimi i kostove administrative dhe eliminimi i barrierave tregtare jotarifore ex-post | 1 | Përditësimi i sistemit të informacionit për barrierave tregtare jotarifore të ndeshura nga eksportuesit shqiptar në vendet e rajonit. | Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU0, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave (DPD), AIDA, DHTI, shoqata të tjera biznesit, donatorë | çdo vit | 36 | |
| | | 2 | Krijimi i një sistemi informacioni për barrierave tregtare jotarifore të ndeshura nga eksportuesit shqiptarë për eksportuesit shqiptarë të destinuar për tregun evropian, turk etj. | | 2015 -2016 | 50 | |
| A.2 | Reduktimi i kostove administrative dhe eliminimi i barrierave tregtare jotarifore ex-ante | 1 | Eliminimi i barrierave jotarifore me fokus: (i) rregullat teknike në tregti; (ii) masat sanitare dhe fitosanitare; (iii) procedurat administrative. | MZHETS, MBZHRAU, Drejtoria e Përgjithshme Standardizimeve (DPS), Drejtoria e Akreditimit (DA), (DPD), në bashkëpunim me OECD dhe grupet e interesit | 2014-2015 | | Sipas metodologjisë së OECD-së |
| | | 2 | Vlerësimi i barrierave jotarifore për një listë prioritare produktesh dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për ndërmarrjen e politikave konkrete. | | 2015 -2020 | | |
| | | 2.1 | Hartimi i një liste prioritare produktesh eksporti ndarë sipas tregjeve respektive. | | | | |
| | | 2.2 | Identifikimi i barrierave jotarifore sipas tregjeve respektive. | | | | |
| | | 2.3 | Hartimi i një plani diskutimi për eliminimin e barrierave si bazë për diskutimet dypalëshe. | | | | |
| | | 3 | Eliminimi i barrierave jotarifore me fokus: (i) rregullat teknike në tregti; (ii) masat sanitare dhe fitosanitare; (iii) procedurat administrative. | MZHETS, MBZHRAU, Drejtoria e Përgjithshme Standardizimeve (DPS), Drejtoria e Akreditimit (DA), Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), në bashkëpunim me GIZ dhe grupet e interesit | çdo dy vjet | 0.86 | |
| | | 4 | Vlerësimi i barrierave jotarifore për një listë prioritare produktesh dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për ndërmarrjen e politikave konkrete. | | | | |
| | | 5 | Krijimi dhe mirëmbajtja e një database për legjislacionin e SPS, TBT dhe procedurave të kalimit të kufirit me vendet e rajonit. | | 2015 | 9.8 | |
| | | 6 | Përditësimi i database për legjislacionin e SPS, TBT dhe procedurave të kalimit të kufirit me vendet e rajonit. | | vazhdimisht | 1 | |
| A.3 | Reduktimi i kostove administrative dhe eliminimi i barrierave tregtare jotarifore (Logjistika tregtare) | 1 | Krijimi i Komitetit Kombëtar për Lehtësimin e Tregtisë. | MZHETS, MF, MBZHRAU, DPD, agjencitë e ndryshme inspektuese që operojnë në kufi, grupet e interesit | 2015 | 42 | |
| | | 2 | Hartimi i platformës për lehtësimin e tregtisë për shtete të caktuara në përputhje me prioritetet. | | 2015-2016 | | |
| | | 3 | Reduktimi i numrit të dokumenteve të nevojshme për importin-eksportin e mallrave. | | 2014 | | |
| | | 4 | Vlerësimi i mundësive për krijimin e *Single Window* në doganë për të lehtësuar transaksionet tregtare, reduktuar kohën dhe koston në kalimin e kufirit. | | 2016-2020 | | |
| A.4 | Liberalizimi i tregtisë së shërbimeve me vendet e rajonit | 1 | Përgatitja e matricës së efekteve shtrënguese në sektor të caktuar. | MZHETS dhe anëtarët e GNP të kapitujve 3 dhe 30, në bashkëpunim me OECD dhe Banka Botërore | 2014-2015 | 1.29 | |
| | | 2 | Vlerësimin e sektorëve dhe masave kufizuese relative, duke nënvizuar shkallën e hapjes të secilit vend të CEFTA-s. | | | | |
| | | 3 | Përgatitjen e dokumentit për hapjen potenciale të negociatave për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve në rajon, në sektorë prioritarë. | | | | |
| | | 4 | Monitorimi i zbatimit të protokollit shtesë për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve me vendet e rajonit. | MZHETS | 2015 e në vazhdim | | |
| | Liberalizimi i shërbimeve të transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave me vendet e rajonit, (me Italinë), heqja e taksave | 1 | Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së lidhur me pranim në veprimtarinë e transportit dhe hyrjen në treg. | Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) | 2014-2015 | 30 | Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, janë miratuar konventa dhe marrëveshje bilaterale mbi transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave dhe për njohjen reciproke të lejeve të |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | diskriminuese ndaj transportuesve shqiptarë rrugorë të mallrave | | | | | | drejtimit me shtetet fqinje, nënshkrimi i të cilave ka patur një impakt të menjëhershëm. Në rritjen e fluksit të mjeteve të mallrave dhe udhëtarëve me këto vende. Jemi në fazën e nënshkrimit të një marrëveshje me Turqinë dhe për të ardhmen synohet të lidhen të njëjtat marrëveshje edhe me Greqinë, Serbinë etj. |
| A.5 | Lëvizja e lirë e ekspertëve, profesionistëve dhe personave të kualifikuar | 1 | Modernizimi i Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Shtrirja e modelit të ri të shërbimit në të gjitha zyrat e punësimit. | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR),Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) | 2014 - 2015 | 36.4 | Është filluar me zyrat pilot në Tiranë, Durrës, Vlorë, Kavajë Elbasan dhe Korçë. |
| | | 2 | Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe institucional në përputhje me standardet e ratifikuara ndërkombëtare të punës. | | 2014 - 2020 | 8 | MMSR është në fazën e miratimit në KM të Strategjisë të Punësimit dhe Zhvillimit të Aftësive 2014-2020. |
| | | 3 | Modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të TI në SHKP | | | 15.2 | |
| | Dimensioni B: Mjedisi ekonomik konkurrues | | | | | | |
| B.1 | Forcimi i rregullave të konkurrencës duke krijuar një zonë tregtie si një instrument për mbrojtjen e tregtisë në rajon | 1 | Përafrimi i legjislacionit, kryesisht atij sekondar në fushën e konkurrencës; përafrimi i rregullores për marrëveshjet në transportin detar, udhëzuesi për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale, si dhe udhëzuesi mbi vlerësimin e abuzimit me pozitën dominuese. | Autoriteti i Konkurrencës, MZHETS | 2014 | 1,2 | |
| | | 2 | Hartimi i një dokumenti të ri të Politikës së Konkurrencës. në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me të gjithë palët interesit, duke synuar rishikimin dhe ridimensionimin e prioriteteve të Politikës Kombëtare të Konkurrencës. | Autoriteti i Konkurrencës, MZHETS, entet rregullatore | | 2,4 | |
| B.2 | Përmirësimi i shërbimeve elektronike | 1 | Krijimi i arkivës elektronike | Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave | 2014 | 5,5 | Kjo do të bëjë të mundur që të gjitha veprimet e kryera me aplikimet për regjistrimin e objekteve të PI të jenë elektronike. |
| | | 2 | Implementimi në IPAS i modulit për depozitimin e të dhënave të mbajtjeve në fuqi sipas nenit 39 të EPC. | | | | Shkëmbimi i të dhënave në Zyrën Evropiane të Patentave (EPO) |
| | | 3 | Mirëmbajtja dhe përmirësimi i faqes së internetit, si dhe modulit për kërkimin *on-line* të objekteve të PI të regjistruara në Shqipëri. | | | | |
| B.3 | Qasja e praktikave evropiane | 1 | Zbatimi i Kodit Evropian të praktikave më të mira që lehtësojnë aksesin e SME-ve në prokurimin publik. | MZHETS, AIDA, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Ministritë e linjës | 2014 | | |
| | | 1.1 | Studimi i nevojave për ndërhyrje legjislative, bazuar dhe në konsultimin me grupet e interesit. | | çdo vit | | |
| | | 2 | Ofrimi i trajnimeve për sipërmarrësit | | | | |
| | Dimensioni C: Integrimi në ekonominë globale | | | | | | |
| C.1 | Përmirësimi i imazhit të vendit | 1 | Organizimi i konferencës së investimeve | MZHETS, AIDA | 2014 | 35 | |
| | Rritja e fluksit të IHD-të duke përshpejtuar procesin e privatizimeve | 1 | Përshpejtimi i procesit të privatizimit: paketat e mbetura shtetërore, si ALTELECOM, CEZ, OSSH, ARMO; në sektorët strategjikë, si HEC, INSIG, ALPETROL; asetet e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM). | MZHETS, Ministria e Financave (MF), AIDA | 2014-2015 | | Procesi i privatizimit do të gjenerojë të ardhura për buxhetin e shtetit |
| | Rritja e fluksit të FDI-ve në sektorë të veçantë, si në industrinë e këpucës dhe veshjeve, biznesin e shërbimeve, dhe të materialeve të ndërtimit etj. | 1 | Përgatitja e një studimi lidhur me avantazhet konkurruese të sektorëve të konfeksioneve, këpucës dhe materialeve të ndërtimit, si dhe sektorë të tjerë dhe potencial rritje e investimi. | MZHETS, AIDA dhe projektin rajonal të OECD | 2014-2020 | 30 | |
| | | 2 | Nxitja e bashkëpunimit rajonal për mbështetjen e zinxhirit të vlerës dhe zhvillimin e tij. | | | | |
| | Zhvillimi i zonave ekonomike, parqeve industriale dhe zonave të lira | 1 | Promovimi i zonave ekonomike dhe parqeve industriale. | AIDA, MZHETS, MTI, MF | 2014 -2020 | | |
| | | 1.1 | Përgatitja e dokumenteve për secilën zonë ekonomike publikimi i hartave të zonave të lira në faqen e internetit. | | | 13,463 | |
| | Forcimi i kapaciteteve të strukturave promovuese dhe implementuese të strategjive dhe politikave qeveritare në fushën e nxitjes së investimeve. | 1 | Identifikimi i investitorëve potencial sipas sektorëve për Shqipërinë. | AIDA me asistencë teknike të donatorëve | 2014-2020 | | |
| | | 1.1 | Përmirësimi i vazhdueshëm i *database* duke siguruar të dhëna në linjën e kërkesave për investime (kërkesë/investigim për investim). | | | | |
| | | 2 | Krijimi i metodikës për matjen e nivelit të kënaqësisë dhe shqetësimeve të investitorëve të huaj. | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përmirësimi i politikave të investimeve të huaja | 1 | Hartimi i raportit të IHD në Shqipëri | MZHETS, BSH, INSTAT, FIAA, AIDA, ministritë e linjës | 2015 | | |
| | | 1.1 | Konsultimi i gjetjeve të raportit të IHD në Shqipëri me investitorët e huaj | MZHETS në bashkëpunim me grupet e interesit | 2015-2016 | | Konsultimi varet nga afati i përfundimit të raportit. |
| | | 1.2 | Hartimi i planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të raportit të IHD në Shqipëri. | | 2016 | | |
| | Përmirësimi i marketingut të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare | 1 | Promovim i potencialeve sektoriale investuese në tregje dhe investitorë të huaj për kthimin e Shqipërisë në destinacion atraktiv për investime. | AIDA, MPJ, MZHETS, MBZHRAU, MF dhe institucione të tjera | 2015-2020 | 364 | |
| | | 1.1 | Përgatitja e spoteve publicitare në mediat e shkruara dhe televizive dhe paketave e broshura informative për mjedisin e biznesit, të gjithë kuadrin ligjor dhe mundësitë e investimeve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. | | | | |
| | Promovimi i biznesit shqiptar në tregjet ndërkombëtare | 1 | Ndërmarrja e një projekti për të rritur komunikimin dhe bashkëpunimin me diasporën shqiptare. | MZHETS, AIDA, MPJ | 2014 | 60 | |
| | | 2 | Studim për hapjen e zyrave përfaqësimi në vendet me potencial më të madh për investime të huaja në Shqipëri. | | 2015-2020 | 200 | |
| | Reduktimi i procedurave panevojshme për biznesin | 1 | Hartimi i Planit Kombëtar për përmirësimin e indikatorëve të "*Doing business*". | MZHETS, ministritë e linjës | 2014-2020 | 1 | |
| | | 2 | Studimi i nevojave për ndërhyrje legjislative për mbështetjen, shansi i dytë për biznese të ndershme të falimentuar, ofrimi i shërbimeve, asistencë teknike për rifillimin e biznesit. | MZHETS, GIZ | 2014-2015 | 0.5 | (Rekomandim i Komisionit Evropian COM(2012) 742). |
| | | 3 | Krijimi i portalit *e-inspection* | Inspektorati Qendror, USAID | 2014-2015 | 70 | |
| | | 3.1 | Reformimi i sistemit të inspektimit, duke plotësuar kuadrin ligjor dhe strukturën organizative. | Inspektorati Qendror, MZHETS | | | |
| | | 4 | Lehtësimi i procedurave në transferimin e një biznesi. | MD, MF, QKR, MZHETS, GIZ etj. | 2014-2015 | | Adoptimi i rekomandimit të KE-s të vitit 2006 si dhe atë të vitit 2011, që merr në konsideratë pengesat fiskale brenda tregut evropian. |
| | | 4.1 | Studimi i nevojave për ndërhyrje legjislative | | | | |
| | Përmirësimi i cilësisë së kuadrit rregullator për biznesin | 1 | Ngritja e sistemit të plotë e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator VNR, (RIA e plotë). | MZHETS, ministritë e linjës | 2017-2020 | | |
| | Reduktimi i kostove për biznesin | 1 | Aplikimi *on line* në QKR dhe QKL për regjistrimin dhe licencimin e biznesit. | QKR, QKL, MZHETS | 2015-2017 | 112 | |
| | | 2 | Depozitimi online i pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit pranë QKR. | QKR, MZHETS | 2015-2017 | 29 | |
| | | 3 | Reduktimi i numrit të licencave dhe lejeve që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe reforma në fushën e autorizimeve. | QKR, QKL, MZHETS | 2015-2019 | 8 | |
| | Rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj biznesit | 1 | Plotësimi i portalit për SME-të dhe fuqizimit të saj, si dhe rrjetit me qendrat e informimit të biznesit. | AIDA, MZHETS | 2016-2020 | | |
| | | 2 | Analiza e nevojave për trajnime për biznesin dhe për sipërmarrjen femërore në veçanti. | | çdo 2 vjet | | |
| | | 3 | Zbatimi dhe zgjerimi i metodës së bërthamës (nukleus) për SME-të, me ekspertizën e GIZ. | | 2016 | | |
| | | 4 | Mbështetje nëpërmjet skemave të financimit me fonde të përvitshme nga buxheti i shtetit për: | | 2014-2020 | 394 | |
| | | | Fondin e inovacionit | | | | |
| | | | Fondin e konkurueshmërisë | | | | |
| | | | Programi për gratë sipërmarrëse | | | | |
| SHTYLLA 2: RRITJE E ZGJUAR | | | | | | | |
| Dimensioni D: Edukimi dhe aftësimi | | | | | | | |
| D.1 | Rritja e pjesëmarrjes në klasat parapërgatitore të arsimit parashkollor | 1 | Përgatitja e dokumenteve strategjike për përmirësimin i kushteve të të mësuarit në përputhje me standardet e BE. | Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Instituti i Zhvillimit Arsimor | 2014-2015 | | |
| | | 2 | Zbatimi i kartës së performancës. | | | | |
| | | 3 | Shkolla informuese mësues - nxënës- prindër. | | | 10 | |
| | | 4 | Implementimi i shkollave si qendra komunitare. | | | 10 | |
| D.2 | Reformë e arsimit | 1 | Korniza e re kurrikulare | MAS | 2014-2015 | 28.2 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | parauniversitar | 2 | Kurrikulat bërthamë | | | | |
| | | 3 | Programet lëndore | | | | |
| | | 4 | Zbatimi i kurrikulës së re | MAS dhe Instituti i Zhvillimit Arsimor | | 37.4 | |
| D.3 | Rritja e cilësisë dhe reformimi i arsimit të lartë | 1 | Përgatitja e ligjit të ri të arsimit të lartë | MAS | 2014-2015 | | |
| | | 2 | Verifikimi i kushteve të licencimit | | | | |
| | | 3 | Skemë e re financimi për universitetet publike | | | | |
| | | 4 | Ngritjen e një organizmi të drejtë e të pavarur vlerësimi, akreditimi dhe renditjeje të universiteteve publike dhe jopublike | | | 36 | |
| | | 5 | Asistencë universiteteve publike në ngritjen dhe fuqizimin e qendrave të këshillimit për karrierën. | | | 30 | |
| | Përmirësim i kapaciteteve njerëzore në fushën e shërbimeve dixhitale në arsim | 1 | *Database* për sistemin e arsimit kombëtar në Shqipëri. | MAS | 2014-2020 | 390 | |
| | | 2 | Zhvillimi i platformës *e-learning* | | | 2,640 | |
| | | 3 | Dixhitalizimi i sistemit kombëtar arsimor në Shqipëri. | | | 1,200 | |
| D.4 | Krijimi e përmirësimi i aftësive menaxhuese dhe trajnuese | 1 | Hartimi i planit të veprimeve për të mësuarit për sipërmarrjen. | MAS, MMSR, MZHETS, AIDA | 2014-2020 | | |
| | | 2 | Zhvillimi i programeve për futjen e sipërmarrjes në programet bazë të edukimit në të gjitha nivelet, nxitja dhe zhvillimi i partneritetit shkollë-biznes, dhe për të gjitha institucionet e tjera që ofrojnë këtë shërbim. | | 2014-2020 | | |
| | | 3 | Hartimi i kurrikulës për sipërmarrjen dhe programeve trajnuese për zhvillimin e aftësisë sipërmarrëse, në kurset disamujore profesionale. | | 2014-2020 | 70.35 | |
| | | 4 | Zhvillimi i programeve trajnuese për 2000 sipërmarrës të rinj, femra që kërkojnë të fillojnë një biznes, diplomuar, të papunët, rikualifikimin dhe informacione të vazhdueshme. | | 2014-2020 | | |
| D.5 | Rritja e kualifikimit të fuqisë punëtore | 1 | Studimi (vjetor) i nevojave për aftësi (SNA) në tregun e punës | MMSR, MAS, MZHETS, AIDA | 2014-2015 | 6 | |
| | | 2 | Përmirësimi i sistemit të trajnimit profesional me pajisje e materiale trajnimi dhe me mësues të kualifikuar. | | çdo vit | | |
| | | 3 | Hartimi dhe implementimi i programeve të trajnimeve dhe moduleve përkatëse për sipërmarrjen. | | çdo vit | | |
| | | 4 | Zgjerimi i rrjetit të përdorimit të internetit në administratën publike një faktor i rëndësishëm në drejtim të reduktimit të korrupsionit dhe abuzimeve në marrëdhënie me biznesin. | | çdo vit | | |
| D.6 | Rritja e kapaciteteve produktive të industrive lokale, nëpërmjet thithjes së njohurive dhe transferimit të teknologjive | 1 | Fuqizimi i kapaciteteve të kompanive nëpërmjet trajnimeve për krijimin e produkteve kompetitive (konkurruese). | MZHETS, AIDA në bashkëpunim me MEI dhe shoqatat e industrisë | Vazhdimisht | | |
| | | 2 | Fuqizimi i network-ut profesional të partnereve të biznesit, nëpërmjet organizmit të forumeve dhe konferencave të biznesit. | MZHETS, me AIDA dhe shoqatat e industrisë | Vazhdimisht | | |
| | Rritja e kapaciteteve investuese në kërkimin shkencor dhe inovacionin për zhvillimin e produkteve industriale | 1 | Zbatimi ë programit strategjik, për zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë, në përfitim të ndërmarrjeve industriale. | MZHETS, në bashkëpunim me AIDA/BRIC dhe AKTI | 2016-2020 | | |
| | | 3 | Mbështetja inovacionit të ndërmarrjeve industriale, nëpërmjet ofruesve të shërbimeve të biznesit (BSP-ve), si agjencitë e zhvillimit rajonal (ARZH-të) dhe këshillimet, për të rritur kapacitetin njerëzor në auditimin e teknologjisë, menaxhimin e inovacionit, dhënien e informacionit, si dhe duke stimuluar punësimin e kërkuesve shkencor dhe menaxhereve me përvojë nga sektori i industrisë. | MZHETS, MEI në bashkëpunim me AIDA/BRIC dhe AKTI | 2016-2020 | | |
| | Rritja e gamës së produkteve ekologjike që bazohen në përdorimin e efektshëm të burimeve për prodhimin e pastër | 1 | Krijimi i një grupi ndërministror lidhur me zbatimin e programit të UN për prodhimin e pastër, duke garantuar që politikat e eficiencës së energjisë dhe prodhimit të pastër, do të gjejnë zbatim në të gjitha strategjitë sektoriale, si industri, miniera, bujqësi, turizëm dhe ushqim. | MZHETS, në bashkëpunim me ECAT, dhe UNIDO dhe UNEP | 2014-2020 | | |
| | | 2 | Integrimi i koncepteve, metodave dhe praktikave të prodhimit të pastër, në legjislacionin shqiptar, si dhe transpozimi i direktivave përkatëse të BE-së. | MZHETS, në bashkëpunim me ECAT, dhe UNIDO dhe UNEP | | | |
| | | 3 | Ndërmarrja e aktiviteteve ndërgjegjësuese për zhvillimin e mëtejshëm të produkteve dhe shërbimeve *eco; eco labeling*, riciklimin dhe certifikimin e tyre, si dhe hartimi i një programi konkret i përqendruar në sektorin e | MZHETS, projekt rajonal me UNIDO | 2014-2015 | 42 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | industrive jo ushqimore. | | | | |
| | | 4 | Ristrukturimi i ndërmarrjeve industriale shtetërore drejt teknologjive të reja për prodhime të pastra. | MZHETS në bashkëpunim me donatorë | 2014-2020 | 2,987 | |
| Dimensioni E: Kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni | | | | | | | |
| E.1 | Promovimi i Ekselencës dhe zhvillimi i kapaciteteve | 1 | Reformim i fondit të ekselencës | MAS | 2014 | 135 | |
| | | 2 | Krijimi i një portali unik për mobilitetin e studentëve | MAS | 2014 | | |
| | | 3 | Ngritja e agjencisë Erasmus + | MAS | 2016 | | |
| E.2 | Mbështetja e kërkuesve shkencorë | 1 | Krijimi i mundësive për angazhimin e kërkuesve shkencorë shqiptarë në universitetet e huaja nëpërmjet programit Horizon 2020. | MAS | 2014-2017 | 248 | |
| | | 2 | Kualifikimi i personelit akademik | MAS në bashkëpunim me Universitetet | 2016 | 115 | |
| | | 3 | Subvencionimi "Transferta e pakushtëzuar", për institucioneve akademike e shkencore në funksion të punës | | 2014- 2017 | 19,930 | |
| E.3 | Përqasja e biznesit me inovacionin | 1 | Pjesëmarrje në programin rajonal EDIF (Fondi i Inovacionit për Ndërmarrjet) për mbështetjen e Inovacionit. | MZHETS, AIDA | 2014-2020 | 27 | |
| | | 1.1 | Hartimi i marrëveshjes së partnershipit me Menaxherin e fondit ENIF (komponenti i parë i EDIF). | | 2014-2015 | | |
| | | 2 | Krijimi i një grupi ndërministror në mbështetje të zhvillimit të konkurueshmërisë. | MZHETS | 2014 | | |
| | | 3 | Nxitja për inovacionin skemës "*voucher*". | MZHETS, AIDA | 2014-2020 | 24 | |
| | | 3.1 | Ndërtimi i konceptit për zhvillimin e skemës "*voucher*" në mbështetje të inovacionit për SME-të. | | | | |
| | | 3.2 | Hartimi i kuadrit ligjor për nxitjen e transferimit të teknologjive dhe inovacionit, nëpërmjet funksionimit të "*inovacion voucher*" etj. | | | | |
| | | 4 | Implementimi dhe zgjerimi i Fondit të Inovacionit, jo vetëm për auditimin për inovacionin të kompanive, por edhe për investime në teknologji me mbështetjen e sistemit bankar. | AIDA | 2014-2020 | 289 | |
| | | 4.1 | Ngritja e 1 (një) inkubatori pilot teknologjik. | | 2015-2020 | 20 | |
| | | 4.2 | Ngritja e 3 (tre) klasterave të rinj në sektorët e industrisë joushqimore. | | 2015-2020 | | |
| | | 5 | Zhvillimi i tregtisë elektronike: pagesat elektronike (*e-payment*), infrastruktura përkatëse, *e-learning*; *e-business*; shërbimet elektronike si *e-hipoteka etj*. Mbështetja e bizneseve fillestare me shërbime dixhitale. | ZRPP, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore, DPT | 2014-2018 | | |
| E.4 | Kooperimit ndërmjet institucioneve kërkimore shkencore | 1 | Nxitja e kooperimit ndërmjet institucioneve kërkimore shkencore, universitetit dhe sektorit të industrisë, duke aplikuar në projekte konkrete të përbashkëta "*triple helix*". | MZHETS, AIDA, MEI, AKTI në bashkëpunim me Universitetin Politeknik-Tiranë | 2016-2020 | | |
| Dimensioni F: Shoqëria digjitale | | | | | | | |
| F.1 | Zhvillimi i infrastrukturës rajonale të *broadband-it* për të ofruar akses në internet me shpejtësi të lartë | 1 | Implementimi i Planit Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband.* | MIAP/AKSHI AKEP | 2014-2020 | | Kostimi i pjesshëm është dhënë në aneksin e dokumentit të miratuar me VKM nr. 468, datë 30.5.2013. |
| | | 2 | Dhënia në përdorim e frekuencave të mbetura në brezin 2.1 GHz për ofrimin e shërbimeve *broadband.* | MIAP/AKEP | 2014 | | Nuk ka kosto për buxhetin e shtetit. Pritet gjenerim të ardhurash nga dhënia në përdorim e frekuencave. Proceset kryhen në përmbushje të detyrave funksionale të MIAP dhe AKEP. |
| | | 3 | Heqja e kufizimeve teknologjike për frekuencat, "*refarming*" për frekuencat në breza 900MHz,1800 MHz. | AKEP | 2014-2017 | | Nuk ka kosto për buxhetin e shtetit. Pritet gjenerim të ardhurash nga dhënia në perdorim e frekuencave. Proceset kryhen në përmbushje të detyrave funksionale të MIAP dhe AKEP. |
| | | 4 | Lirimi i frekuencave të digital dividentit (790-862 MHZ). | AMA/AKEP/MIAP | 2015 | | Nuk ka kosto për buxhetin e shtetit. Është aktivitetet që parashikon mundësimin e këtij brezi për shërbime broadband. |
| | | 5 | Përmirësimi i kuadrit ligjor për komunikimet elektronike për lejet e rrjeteve të komunikimeve elektronike në kuadër të procesit të ndryshimeve në ligjin për planifikimin e territorit. | MIAP | 2014 | | Në përmbushje të detyrave funksionale MIAP. Nuk ka kostim. |
| | | 6 | Rishikimi i Memorandumit të bSEE në kuadër të iniciativës e-SEE | RCC/MIAP/AKSHI | 2015 | | Varet nga kooperimi me RCC me vendet |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | pjesëmarrëse në iniciativën e SEE |
| F.2 | Zhvillimi i shërbimeve elektronike ndërmjet shteteve duke u dhënë përparësi fushës së shëndetësisë, edukimit, tregtisë | 1 | Hartimi i Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit, bazuar në Kornizën Evropiane të Ndërveprimit dhe standardet ndërkombëtare. | MIAP/AKSHI | 2014 | | Në zbatim të detyrave funksionale të AKSHI parashikuar në aktivitetet e vitit 2014. Nuk ka kostim. |
| | | 2 | Ofrimi i 4 shërbimeve të reja elektronike:<br>Në fushën e tatimeve: deklarimi i të ardhurave personale nëpërmjet portali qeveritar *e-albania.al*;<br>rritja e transparencës në administratën publike;<br>implementimi i sistemit *e-Tracking* në ministritë linjave; | AKSHI | 2014-2015 | 10 | Në bashkëpunim me institucionet e tjera. Deklarimi i të ardhurave personale parashikuar në aktivitetet e vitit 2014 të AKSHI. Kostimi prej 10 milionë lekë për krijimin e portalit opendata si nendomain i portalit www.e-albania.al. Realizimi i sistemit të *e-tracking* është pjesë e Marreveshjes së Microsoft, nëproces kostimi. |
| | | | Pilotimi i procesit të implementimit të *e-Signature* në ofrimin e shërbimeve dhe komunikimeve zyrtare. | AKSHI | 2014 | | Realizuar investimi i infrastrukturës PKI. Implementimi gradual në institucione. Kosto e shpërndarë në çdo insititucion për USB tokens. |
| | | 3 | Adoptimi i ndryshimeve të direktivës për nënshkrimin elektronik në legjislacionin vendas me qëllim harmonizimin e tij me *acquis communaitare.* | MIAP/AKCE | 2016 | | Pritet që EC të miratojë ndryshime në direktivën e *e-signature* këtë vit. |
| | | 4 | Organizimi dhe ndjekja e implementimit të nënshkrimit elektronik në disa nga shërbimet publike, të cilat ofrohen *online*. | MIAP/AKSHI/AKCE | 2014-2020 | | Në zbatim të detyrave funksionale të AKCE dhe AKSHI. Nuk ka kostim. |
| F.3 | Sigurimi i mundësisë për trajnim për TIK-un, sepse fitimi i shprehive dixhitale zgjeron mundësitë për punësim | 1 | Trajnime përmes pjesëmarrjes në seminare rajonale për aspekte të ndryshme për TIK dhe *e-government.* | MIAP/DAP | 2014-2020 | | Administrata publike është duke përfituar në kuadër të nismës rajonale RESPA. |
| | | 2 | Studimi dhe fillimi i implementimit të sistemit *e-learning* për trajnimin dhe dixhitalizimin e materialeve të trajnimit. | | | | |
| | Dimensioni G: Sektori i kulturës dhe krijimtarisë | | | | | | |
| G 1 | Procesi i Ljubjanës – Vazhdimi i rehabilitimit të integruar të trashëgimisë kulturore | 1 | Rishikimi dhe miratimi i Ligjit për Trashëgiminë Kulturore | Ministria e Kulturës | 2014 | 40,000 | Buxheti i Ministrisë së Kulturës dhe donatorë |
| | | 2 | Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe peizazhi i sitit arkeologjik të Apolonisë | Ministria e Kulturës dhe Delegacioni i BE në Shqipëri | 2014 - 2015 | 112 | Zbatimi i projektit i planifikuar të fillojë në katërmujorin e fundit të 2014 dhe do të përfundojë në katërmujorin e tretë të 2015. 98 - financuar nga BE dhe 11.2 - nga Qeveria Shqiptare +20% TVSH. |
| | | 3 | Ndërhyrje emergjente në Trapezarinë e Manastirit të Apolonisë | Ministria e Kulturës (IMK) | 2014 | 1 | Financimi është përfituar, ndërhyrjet emergjente po zbatohen nga IMK. |
| | | 4 | Trajnime për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore | Ministria e Kulturës | 2014-2015 | 20,000 | financim i nevojshëm |
| | | 5 | Rivitalizimi i Muzeut Kombëtar Arkeologjik të Durrësit | | 2015 - 2020 | 1,500,000 | IPA II - bashkëfinancim në vlerën 10-20% +TVSH 20 % |
| | | 6 | Restaurim i mureve të kalasë dhe monumente kulturore në Berat | | 2015 - 2020 | 2,600,000 | IPA II - bashkëfinancim në vlerën 10-20% ( Bashkia Durrës ) +TVSH 20 % ( MK) |
| | | 7 | Përmirësimi teknologjik i Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore | | 2015-2020 | 30,000 | Financim I nevojshëm |
| | | 8 | Pajisja me mjete e laboratorëve të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik | | 2015 - 2020 | 20,000 | IPA II - bashkëfinancim në vlerën 10-20% +TVSH 20 % |
| | | 9 | Trajnimi i stafeve për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore | | 2015 - 2020 | 50,000 | financim i nevojshëm |
| G 2 | Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e mëtejshëm të metodologjisë së integruar dhe ngritjes së fondeve | 1 | Organizimi i worshopeve për hartimin e planeve të biznesit & sigurimin e fondeve. | Ministria e Kulturës | 2014-2015 | 20,000 | financim i nevojshëm |
| | | 2 | Trajnime për metodat e ruajtjes organizuar nga Shkolla Rajonale e Restaurimit | | | 30,000 | |
| | | 3 | Trajnime për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me metodologjinë e procesit të Lubjanës | | | 20,000 | |
| G 3 | Ngritja e mekanizmit për sigurimin e bashkëpunimit në nivel rajonal, në sektorin audio- | 1 | Rishikimi i ligjit për të drejtat e autorit. | Ministria e Kulturës | 2014-2015 | 1,000,000 | Financim i nevojshëm në kuadër të IPA II |
| | | 2 | Dixhitalizimi i sistemit të monumenteve të kulturës | | 2014-2015 | 40,000 | Buxheti i Ministrisë së Kulturës |
| | | 3 | Përditësimi i listës së monumenteve të kulturës | | 2014 | 30,000 | Buxheti i Ministrisë së Kulturës |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | vizual | 4 | Dixhitalizimi i krijimtarisë kombëtare | | 2015 - 2020 | 200,000 | Financim i nevojshëm në kuadër të IPA II |
| G 4 | Inkurajimi i bashkëpunimit aktiv ndërmjet organeve të politikave të filmit, transmetuesve publikë, kompanive të prodhimit dhe shpërndarjes | 1 | Anëtarësimi në: South East European Cinema Network (SEECN); Eurimages; European Film Promotion | Qendra Kombëtare e Kinematografisë | 2014-2020 | 118,000 | Buxheti i Qendres Kombëtare Kinematografike |
| | | 2 | Hartimi i kalendarit të perbashket kulturor me Kosovën; nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Maqedoninë, Malin e Zi, Greqinë për aktivitete të perbashketa kulturore. | Ministria e Kulturës | 2014 | 20,000 | Buxheti i Ministrisë së Kulturës |
| G 5 | Krijimi i mekanizmit rajonal për bashkëpunim ndërmjet muzeve, që synon të modernizojë dhe të përmirësojë funksionimin dhe menaxhimin e tyre | 1 | Rishikimi i ligjit për muzetë | Ministria e Kulturës | 2014-2015 | 10,000 | Ekspertizë |
| | | 2 | Rikonstruksion i Muzeut Virtual Marubi. | | 2014 | 120,000 | Projekt i financuar nga UNDP dhe rajoni i Reggio Emiglia-s |
| | | 3 | Zbatimi i strukturës së re drejtuese për Muzeun Historik Kombëtar | | 2015 - 2020 | 20,000 | Buxheti i Ministrisë së Kulturës |
| | | 4 | Krijimi i muzeut kombëtar të etnografisë | | 2015 - 2020 | 1.500,000 | Financim i nevojshëm |
| G 6 | Ngritja e inkubatorit të projekteve rajonale | 1 | Pjesëmarrja në takime të përbashkëta | Ministria e Kulturës | 2014 | 5,000 | Buxheti i Ministrisë së Kulturës |
| | | 2 | Krijimi i rrjetit të bashkëpunëtorëve, Konferencë për Artizanatin dhe mundësitë e bashkëpunimit mes prodhuesve artizanale dhe disenjatorëve të trajnuar mbi përdorimin e motiveve tradicionale. | | 2015-2020 | 20,000 | Financim i nevojshëm,TAIEX |
| | | 2.1 | Ngritje kapacitetesh në funksion të ngritjes së inkubatorit të projekteve rajonale. | | 2015 - 2020 | 10,000 | Buxheti i Ministrisë së Kulturës |
| G 7 | Zhvillimi i një sistemi me statistika bazë për kulturën dhe industritë krijuese në rajon, të krahasueshëm me indikatorët e BE-së | 1 | Krijimi i hartës së industrive kreative dhe ngritja e një sistemi të dhënash për raportimin periodik. | Ministria e Kulturës | 2014 -2020 | 30,000 | Financim i nevojshëm |
| SHTYLLA 3: Rritja e qëndrueshme | | | | | | | |
| Dimensioni H: Energjia | | | | | | | |
| H.1 | Plani i Parë Kombëtar i Veprimit për energjitë e rinovueshme | 1 | Hartimi i Planit Kombëtar të parë në përputhje me direktivën 2009/28/Ec është 38% për vitin 2020. | MEI/AKBN/Partneriteti publik dhe privat/shoqëria civile/ | 2014-2020 | 4 | Kjo në linjë me zhvillimin e energjive të rinovueshme në Shqipëri dhe Rajon dhe njëkohësisht kërkesë e *acquis* për energjinë e rinovueshme |
| H.2 | Plani i Dytë Kombëtar i veprimit të Eficencës së Energjisë (PKVEE) | 1 | Hartimi Planit Kombëtar të dytë i cili do të marrë në konsideratë mos arritjen e objektivit për reduktimin e konsumit të energjisë me 5% për vitin 2014 sipas planit të parë. | MEI/AKBN/Partneriteti publik dhe privat/shoqëria civile/ | 2014-2020 | 938,000 | Krijimin e agjencisë përgjegjëse dhe menaximin e fondit brenda buxhetit të shtetit. Ky objektiv i cili për vendet e tjera është 20% deri në 2020-ën është një sfidë që mund të realizohet vetëm nëpërmjet përditësimit të ligjit aktual për eficencën e energjisë dhe sidomos me krijimin e Fondit për eficenën e energjisë. |
| | | 2 | Zhvillimi i instrumenteve për të përmirësuar efiçencën e përdorimit të energjisë në godinat publike. | | 2014 | | |
| H.3 | Zhvillimi i instrumenteve për informimin dhe fuqizimin e konsumatorëve për të arritur ndryshime të sjelljes që do të rrisnin nivelet e përballimit dhe të sigurisë | 1 | Përmirësimi i performancës së CEZ për uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve në sektorin e shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel kombëtare dhe lokal. | Shoqatat e konsumatorëve, Shoqëria civile, ERE | 2014–2020 | 8 | Kosto administrative |
| | | 2 | Fushatë sensibilizuese, në mënyrë që konsumatori të ndryshojë mënyrën e sjelljes në përdorimin e energjisë elektrike. | | | | |
| H.4 | Krijimi i një klime miqësore për investimet dhe të stimuloni zhvillimin e infrastrukturës energjetike | 1 | Rishikimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor i sektorit elektroenergjetik. | MEI, ERE, MF dhe AIDA | 2014–2020 | 12 | ECS, RCC |
| | | 2 | Marrja e masa të ndryshme për nxitjen e investimeve. | | | | |
| | | 3 | Thjeshtimi/lehtësimi i procedurave dhe shkurtimi i kohëve për trajtimin e kërkesave për dhënien e lejeve për ndërtimin e objekteve gjeneruese të energjisë. | | | | |
| | | 2 | Rishikimi i sistemit tarifor për energjinë e prodhuar nga objektet gjeneruese të energjisë elektrike, si dhe tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes, në mënyrë që ato të pasqyrojnë kostot reale të këtyre operacioneve. | | | | |
| | | 3 | Hartimi i një studimi për kthimin në "Konsumatorë të kualifikuar" të konsumatorëve që furnizohen në tensionin 20 dhe 35 kV. | | | 10 | Kosto administrative |
| H.5 | Zhvillimi i instrumenteve për të | 1 | Rishikimi i Modelit të Tregut i Energjisë Elektrike, në mënyrë që të | MEI | 2014-2020 | 20 | Kosto administrative |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | krijuar mirëfunksionimin e tregut energjetik në EJL që do të sigurojë furnizim të përballueshëm që pasqyron koston dhe nga burime të besueshme; heqja subvencioneve për energjinë dhe zëvendësimi me rrjetet e sigurisë për konsumatorët në nevojë | | pasqyrohen zhvillimet e fundit në këtë sektor me miratimin e ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike". | | | | |
| | | 2 | Rishikimi i skemës së tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë (300 KWh në muaj), në mënyrë që të eliminohen subvencionet dhe të kompensohen direkt shtresat e ndryshme shoqërore me të ardhura të ulëta. | MIE, MMSR, Shoqatat e konsumatorëve, shoqëria civile, kompanitë energjetike, ERE | | 18 | |
| | Përmirësimi i transparencës së tregut dhe praktikave tregtare për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, duke përmirësuar dhe aksesin për dëmshpërblim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve | 1 | Eliminimi i kushteve të padrejta në kontratën standard të energjisë, mbas vlerësimit të kësaj kontrate nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve. | MZHTES | 2014 | 1 | |
| | | 2 | Hartimi i aktit nënligjore në lidhje me etiketimin e energjisë për kondicionerë, në zbatim të ligjit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji . | MZHTES | 2014 | 1 | |
| | | 3 | Përditësimi i informacionit dhe funksionimi i faqeve zyrtare elektronike të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve. | MZHTES ERE | 2015 | 1 | |
| | | 4 | Hartimi i aktit nënligjore në lidhje me etiketimin e energjisë për llambat e ndriçimit, në zbatim të ligjit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji. | MZHTES | 2015 | 1 | |
| H.6 | Plotësimi i bashkëpunimit të vazhdueshëm rajonal për energjinë në lidhje me forcimin e bashkëpunimit, pakësimin e efektit serë prej emetimeve të gazrave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë nëpërmjet zbatimit të Iniciativës Rajonale të Zhvillimit të Qëndrueshëm Energjetik (SEDRI) | 1 | Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë për përcaktimin e plotësimit të kërkesës për energji deri në vitin 2020 dhe me tej, duke parë dhe riverifikimin e burimeve primare të energjisë, në mënyrë që efekti serë të +E83 jetë minimal. | MEI, MM, autoritetet lokale dhe shoqëria civile | 2014-2016 | 30 | RCC |
| | | 2 | Zhvillimi i detajuar i dy masave kombëtare për reduktimin e gazeve me efekt serrë (NAMA), në kuadër të Komunikimit të Tretë Kombëtar. | MEI, Ministria e Mjedisit Programi i Ndryshimeve Klimatike, UNDP | 2014 | 3 | Kosto për përmbushjen e kësaj mase do të mbulohet nga Programi i Ndryshimeve Klimatike, UNDP. |
| | | 3 | Zbatimi i standardeve të ngrohjes diellore nëpërmjet aplikimit të paneleve diellore për 16 ndërtesa të reja publike në qytetet: Tiranë, Lezhë, Elbasan, Gamsh, Berat, Fier, Orikum dhe Himarë. | Ministria e Mjedisit, MEI Programi Ndryshimeve Klimatike, UNDP | 2014 | 5 | Kosto për përmbushjen e kësaj mase do të mbulohet nga Programi i Ndryshimeve Klimatike, UNDP. |
| | | 4 | Zbatimi i standardeve të ngrohjes diellore nëpërmjet aplikimit të paneleve diellore në qytete të tjera të vendit, të cilat do të identifikohen gjatë vitit 2014. | Ministria e Mjedisit, MEI Programi i Ndryshimeve Klimatike, UNDP | 2015 | 5 | Kosto për përmbushjen e kësaj mase do të mbulohet nga Programi i Ndryshimeve Klimatike, UNDP |
| | | 5 | Hartimi i Strategjisë Kombëtare me Karbon të Ulët. | Ministria e Mjedisit, ministritë e linjës | 2016 | 280 | Hartimi i kësaj Strategjie është parashikuar në projektfishën e miratuar në kuadër të IPA 2013; Projekti parashikohet të fillojë në fund të 2014. |
| | | 6 | Ngritja e Sistemit Kombëtar të Monitorimit, Verifikimit dhe Raportimit të Gazeve me Efekt Serrë. | Ministria e Mjedisit, ministritë e linjës | 2016 | | Ky aktivitet është parashikuar në projektfishën e miratuar në kuadër të IPA 2013 |
| | | 7 | Hartimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e Strategjisë me Karbon të Ulët. | Ministria e Mjedisit, ministritë e linjës | 2016 | | Kostoja e projektit është 2 milionë euro, por brenda kësaj shume përveç masave 5,6,7 do të bëhet edhe transpozim i legjislacionit të BE-së për ndryshimet klimatike në legjislacionin kombëtar. |
| | Dimensioni I: Transporti | | | | | | |
